



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2023:014212

Datë: 05.03.2024

Numri i dokumentit: 05410757

**P.nr.25/23**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA NË ISTOG, Departamenti i Përgjithshëm,** Gjyqtari i vetëm gjykues Petrit Nrecaj, me procesmbajtësen Hale Ahmetaj, në çështjen penale kundër të pandehurit V.Jpër shkak të veprave penale ndërtimi pa leje nga neni 359 par. 3 lidhur me par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tutje KPRK), dhe veprës penale heqja apo dëmtimi i shenjave apo i vulave zyrtare nga neni 406 par. 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.2714/22 të datës 23.01.2023, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit fillestar më datë **16.02.2024** në prezencën e Prokurorit të Shtetit Dorjan Juniku dhe të pandehurit V.J se bashku me mbrojtësin te tij av.Haxhi Sinani nga Peja, të njëjtën ditë mori dhe shpalli, ndërsa me datë 05.03.2024, përpiloi, këtë:

### **A K T G J Y K I M**

#### **I pandehuri:**

**V.J**nga i ati B. dhe e ëma Sh. e gjinisë G., i lindur me datë ... në fshatin S. i Ulët, me vendbanim në P. rr. “UÇK” nr.100, i martuar, baba i gjashtë fëmijëve, ka të kryer shkollën e lartë komerciale, me profesion ekonomist, me gjendje të mesme ekonomike, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në liri.

### **ËSHTË FAJTOR**

#### **Sepse:**

1. Në kohë të panjohur e në vazhdimësi e gjer me datë 16.01.2023 në fshatin C., në rr. “Selman Kadrija” nr.91 Komuna I., si investitor rindërton pa leje në ish objektin e pompës se derivateve “Vager” si ndërtim i kategorisë së dytë, për të cilin kërkohen kushtet e ndërtimit dhe leja e tillë në bazë të Ligjit për Ndërtim dhe atë nenit 7 dhe 14 ne atë mënyrë qe pasi zyrtaret policor te stacionit policor në Istog kishin marrë informata se në fshatin C. në I., është duke u rindërtuar një strehë e pompës se

derivateve në fjalë, të njëjtit se bashku me inspektoren komunale këtu dëshmitaren Burbuqe Pepaj kanë shkuar në vendin e sipërshënuar ku kanë konstatuar se i pandehuri në njësinë kadastrale nën P-nr-70806057-00347-2 ZK Istog, kishte filluar rindërtimin e një strehe-mbuloje ekzistuese duke bërë ndryshimin e saj në raport me gjendjen paraprake, ashtu që i njëjti ka dalë me konzol për dy metra në pjesën e përparme deri në skaje asfaltit, për të cilën nuk kishte as kushte ndërtimi e as leje nga organet Komunale dhe për këtë me datë 20.10.2022 nga Inspektorati i është ndaluar puna.

- me çka ka kryer veprë penale, **ndërtimi pa leje nga neni 359 par.3 lidhur me par. 2 të KPRK-së.**

2. Me datë 21.10.2022 në kohë të pacaktuar në fshatin C. Komuna I., me dashje heq shenjën e ngjitur nga zyrtari i autorizuar me qëllim të sigurimit të objektit në atë mënyrë që pasi Inspektorët Komunal të Ndërtimit kishin shkuar në vendin e lartcekur dhe kishin konstatuar se i pandehuri po bënte rindërtimin e një strehe-mbuloje ekzistuese nga një konstruksion metalik, pa u pajisur me kushte ndërtimi dhe leje ndërtimi ashtu që të njëjtit ia ndërpresin punimet duke i vendosur shenjat zyrtare siç janë shiritat të cilat përcaktojnë ndalimin e punimeve pa leje, ashtu që pasi inspektorët e ndërtimit shkojnë në kontrole të serishme, në vendin e sipërshënuar me datë të lartcekur konstatojnë se i pandehuri kishte hequr shenjat e ngjitura nga zyrtarët e autorizuar dhe kishte vazhduar me punime.

- me çka ka kryer veprë penale, **heqja apo dëmtimi i shenjave apo i vulave zyrtare nga neni 406 par.1 të KPRK-së,**

Andaj, gjykata duke u bazuar në nenet e lartcekura të veprave penale dhe dispozitat e nenit 2, 4, 7, 17, 21, 38, 40, 42, 43, 69, 71, 76 të KPRK-së dhe nenet 242, 364 të Kodit të Procedurës Penale (tutje KPP-së), të pandehurit i:

### CAKTON

- Për veprën penale në pikën 1, ndërtimi pa leje nga neni 359 par.3 lidhur me par. 2 të KPRK-së, i caktohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit i konvertohet në dënim me gjobë në shumën prej treqind (300) euro,
- Për veprën penale në pikën 2, heqja apo dëmtimi i shenjave apo vulave zyrtare nga neni 406 par.1 të KPRK-së, i caktohet dënim me gjobë në shumë prej dyqind (200) euro.

Gjykata konform nenit 76, par. 1 dhe 2 të KPRK-së, të pandehurit i shqipton:

## DËNIM UNIK ME GJOBË

- I. Ashtu që, të pandehurit V.J i shqiptohet dënim unik me gjobë në shumë prej pesëqind (500) euro, të cilën gjobë obligohet që ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- Nëse i pandehuri nuk mundet apo nuk dëshiron ta paguan dënimin me gjobë në afatin kohor të përcaktuar me lartë, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet me dënim me burgim, konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, ku për çdo njëzet (20) euro të gjobës, do ti llogariten me një (1) ditë burgim, *përkatësisht 25 ditë burgim.*
- II. **URDHEROHET** rrënimi i rindërtimit pa leje të “Strehës së pompës se derivateve në ish objektin e pompës se derivateve “Vager””, e rindërtuar paleje në fshatin Cërrcë, rr. “Selman Kadrija” nr.91, afër aksit rrugor të rrugës rajonale Istog – Vrellë, në njësinë kadastrale P-nr-70806057-00347-2 ZK Istog, pronë private e H.H Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, këtë urdhër duhet ta ekzekutoj Komuna e Istogut. Shpenzimet e rrënitimit duhet ti bart i pandehuri, VJ
- III. **OBLIGOHET** i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës të paguaj, për paushallin gjyqësor shumë prej **njëzet (20) euro**, ndërsa në emër të taksës për programin për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumë prej **njëzet (20) euro**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- IV. **Palë të dëmtuar:** nuk kishte.

## A r s y e t i m

### Rrjedha e procedurës penale

Në këtë gjykatë, Prokuroria Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.2714/2022 të datës 23.01.2023, kundër të pandehurit V.J për shkak të veprave penale ndërtimi pa leje nga neni 359 par.3 lidhur me par.2 të KPRK-së dhe veprës penale heqja apo dëmtimi i shenjave apo vulave zyrtare nga neni 406 par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar me datë 16.02.2024, në të cilën seancë kanë prezantuar Prokurori i Shtetit Dorjan Juniku dhe i pandehuri V.J se bashku me mbrojtësin e tij av.Haxhi Sinani i caktuar sipas autorizimit, ku pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, gjykata pasi që është bindur se i pandehuri e ka kuptuar akuzën, dhe pas njoftimit me benifitet dhe pasojat e pranimin të fajësisë, i ka mundësuar të pandehurit të deklarohej për pranimin e fajësisë apo të deklarohej i pafajshëm.

**I pandehuri V.J**, pas konsultimit me mbrojtësin e tij, ka deklaruar: se e pranon fajësinë për dy veprat penale për të cilat akuzohet, është i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë, pranimin e fajësisë e bëj në mënyrë vullnetare dhe pa presion nga askush, duke shtuar se është përndarë shumë për këto veprime dhe i premtun gjykatës se ne të ardhmen do të këtë sjellje të mira dhe nuk do të kryej vepra penale.

**Prokurori i shtetit**, lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka deklaruar: se pajtohem me pranimin e fajësisë të deklaruar nga ana e të pandehurit për veprat penale për të cilat akuzohet, një pranimi tillë u bë në mënyrë vullnetare dhe gjënë mbështetje të plote edhe me provat që gjenden në shkresë të lëndës.

**Mbrojtësi i të pandehurit av. Haxhi Sinani ka deklaruar:** se pajtohem me pranimin e fajësisë se të mbrojturit tim, i cili pranim fajësie është i vullnetshëm pa asnjë lloj ndikimi dhe pranimi në fjalë është bërë pas konsultimeve të mjaftueshme që kam pasur me të mbrojturin tim duke ia shpjeguar të gjitha benifitet dhe pasojat e pranimin të fajësisë, andaj i propozoj gjykatës që të bën aprovimin e pranimin të fajësisë dhe poqë se pranohet fajësia i propozoj gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit mbi dënim si rrethanë lehtësuese gjykata të marrë pranimin e fajësisë në të gjitha fazat e procedurës, faktin që i mbrojturi im nuk ka qenë me parë i gjykuar për vepra penale, është pensionist, baba i gjashtë fëmijëve, i njëjti vullnetarisht ka heq dorë nga shfrytëzimi i pompës për të cilën akuzohet ashtu që i propozoj gjykatës që ndaj të njëjtit të shqiptoj një dënim sa me të butë dhe atë nën minimum ligjor i cili dënim japim pëlqim t'i zëvendësohet në dënim me gjobë, e i cili dënim do të ndikoj që i mbrojturi im në të ardhmen mos të kryej vepra tjera penale.

#### Vlerësimi i pranimin të fajësisë

Gjykata në rastin konkret lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, pas marrjes së mendimeve të lartcekura, si dhe se pas vërtetimit se janë përmbushur kërkesat nga neni 242 par. 1, par. 2 nën par. 2.1, 2.2 dhe 2.3, dhe par.3 të KPP-së, përkatësisht pas vlerësimit se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se ky pranim është bërë në baza vullnetare dhe se mbështetet në faktet dhe provat që përmban aktakuza, po ashtu pas vërtetimit se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike të paraparë me nenin 242 par. 2, nën par. 2.4 të KPP-së, gjykata ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri për veprat penale të lartcekura për të cilat është akuzuar.

#### Vendimi për shpalljen fajtor

Gjykata nga të lartcekurat ka vendosur që të pandehurin t'a shpall fajtor për veprat penale për të cilat është akuzuar dhe e ka gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që gjeti se i njëjti është penalisht përgjegjës dhe se nuk ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale të pandehurit, po ashtu në veprimet e tij manifestohen të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprave penale të lartcekur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Pas pranimin të fajësisë nga i pandehuri dhe konstatimit nga gjykata të përmbushjes së kushteve në referim të nenit 242 par. 1, 2 dhe 3 të KPP-së, gjykata ka vlerësuar se nuk është e nevojshme

vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

#### Rrethanat që janë marre për bazë me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e marrjes së vendimit sa i përket sanksionit penal, përkatësisht me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, vlerësoi të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese, të cilat konform nenit 69 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si **rrethana lehtësuese** ka gjetur se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, nuk ka qenë i dënuar me parë dhe rrethanat personale, pendimin dhe premtimin se ne te ardhmen nuk do të kryejë vepra penale; ndërsa **rrethana rënduese** nuk ka gjetur. Andaj, Gjykata në rastin konkret nga rrethanat e lartcekura, ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e këtu të pandehurit, i cili do ta kuptoj rëndësinë e veprës penale të cilën e ka kryer dhe në këtë mënyrë i njëjti do të reflektoj që në të ardhmen mos të shkaktoj veprime të ndaluara- përkatësisht mos të kryej vepër penale, si dhe do të ndikoj tek personat tjerë të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit konform nenit 38 të KPRK-së.

Gjykata, në kuptim edhe të dispozitave të nenit 71 par.1 nënpar.1.3 dhe nenit 72 të KPRK-së, e ne referim të gjitha rrethanave lehtësuese e sidomos pranimin e fajësisë, dhe ne mungese të rrethanave rënduese, ndaj të akuzuarit për veprën penale *ndërtimi pa leje nga neni 359 par.3 lidhur me par.2 të KPRK-së*, ka aplikuar dispozitat për zbutje të dënimit me burgim nën kufirin e paraparë ligjor – minimum, duke vlerësuar se edhe me dënimin e shqiptuar për këtë vepër penale ndaj të akuzuarit të precizuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi do të arrihet qëllimi i dënimit.

Gjykata në këtë çështje penale, vendimin për zëvendësimin e dënimit me burgim më dënim me gjobë, të shqiptuar për shkak të veprës penale *ndërtimi pa leje nga neni 359 par.3 lidhur me par.2 të KPRK-së*, e ka marrë konform nenit 44 të KPRK-së, meqenëse edhe i pandehuri përmes mbrojtësit të tij, ka dhënë pëlqim se ne rast që gjykata i shqipton dënim me burgim deri në gjashtë muaj, i njëjti dënim të zëvendësohet në dënim me gjobë.

#### Vendimi për rrënimin e objektit pa leje

Gjykata ka vendosur, që të urdhërohet rrënimi i objektit të ndërtuar pa leje i precizuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform dispozitës ligjore nga neni 359 par.5 të KPRK-së, e cila dispozitë ligjore është e karakterit obligativ dhe e obligon gjykatën se, në çdo rast kur vërtetohet se është kryer vepra penale nga ky nen, duhet të rrënohen objektet paleje dhe shpenzimet e rrënimin i ngarkohen kryerësit të veprës penale. Ndërsa këtë urdhër duhet ta ekzekutoj komuna në territorin e të cilës gjendet objekti i tillë i ndërtuar në kundërshtim me Ligjin për Ndërtim.

#### Shpenzimet e procedurës

Gjykata duke vendosur lidhur me shpenzimet e procedurës, në kuptim të nenit 452 par. 1 dhe nenit 449 par. 2 të KPP-së, e ngarkoi të akuzuarin me shpenzimet e procedurës të precizuara si

ne dispozitiv të këtij aktgjykimi, e po ashtu konform Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimin, e obligoi të paguaj shumën prej 20 euro në emër të taksës për programin për kompensimin e viktimave të krimin.

Kërkesat pasurore-juridike

Sipas përmbajtjes së aktakuzës në këtë çështje penale, nuk ishte e përcaktuar asnjë palë e dëmtuar.

Gjykata duke u bazuar në arsyet e lartshënuara e në bazë të neneve 242, 364 dhe 369 të KPP-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA NË ISTOG**  
**Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal**

**Procesmbajtësja**  
**Hale Ahmetaj**

**Gjyqtari i vetëm gjykues**  
**Petrit Nrecaj**

---

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit të Kosovë në Prishtinë, *në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.*